

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ALFI, menaxhim me fondet alternative të investimeve, d.o.o., me seli të regjistruar në adresën Veroshkova ulica 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, dorëzuar përmes Lupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 21.05.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ALFI, menaxhim me fondet alternative të investimeve, d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Veroshkova ulica 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, synon të fitoj kontroll të pavarur mbi shoqërinë Panorganiks – tregti me shumicë të frutave dhe perimeve, me seli të regjistruar në adresën Rada Pushenjaka 45, 9240 Lumoter, Republika e Sllovenisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në **përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet paraqitësi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin në shumën prej 6.000,00 den. dhe për vendimin shumën prej 30.000,00 den., sipas tarifës numër 34 të Ligjit për taksat administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogari pagese 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e një kontesti administrativ nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 16.04.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ALFI, menaxhim me fondet alternative të investimeve, d.o.o., me seli të regjistruar në adresën Veroshkova ulica 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, me të cilin ALFI synon të fitoj kontroll të pavarur mbi shoqërinë Panorganiks, tregti me shumicë të frutave dhe perimeve, me seli Rada Pushenjaka 45, 9240 Lumoter, Slloveni, nëpërmjet blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe mbi bazën e të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për Përqendrim dhe anekset që i bashkëlidheshin, përcaktoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ALFI menaxhon me fondet alternative të investimeve (ALFI) bën analizën e (potencialeve) investimeve dhe menaxhimin e fondeve investuese, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve është pjesë e shoqërisë tjetër.

ALFI menaxhon fondet investuese ALFI II (ALFI II – themeluar me emrin ALFI II, fonde investimesh speciale), ALFI DIJ CEE (them. si ALFI DIY CEE, fonde alternative investimesh), si dhe ALFI SIS (ALFI SIS; themeluar si ALFI, fonde speciale investimesh në likuidim).

Grupi ALFI, në kuptimin më të gjerë, ka prezencë lokale nëpërmjet shoqërisë së varur indirekte:

-APOLLO MK SHPKNJ Shkup, me seli në Bulevardi Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Baba, Shkup, dhe realizon të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes tregtisë me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, galanteri fëmijësh dhe tekstile për fëmijë.

Grupi ALFI vepron kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe pronës, kryesisht në fushat e shitjes me pakicë, arkëtimit të borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi ALFI kryen analizën e (potencialeve) investimeve dhe menaxhim të fondeve investuese, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve u besohet pjesërisht shoqërive të tjera brenda grupit.

Megjithatë, Grupi ALFI aktualisht nuk ka investime apo veprimtari afariste në fushën e prodhimit dhe shitjes së perimeve dhe frutave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Panorganiks, tregti me shumicë të frutave dhe perimeve është një shoqëri shqiptare, e themeluar në vitin 2017 dhe është aktive në prodhimin organik të perimeve me gjethe, si sallatë e gjelbër, spinaq dhe barishte për erëza, si dhe hudhër dhe boronica, duke përdorur burime minimale, duke shmangur pesticidet dhe me emetim zero të dyoksidit të karbonit.

Panorganiks, tregti me shumicë të frutave dhe perimeve, aplikon qasje inovative në bujqësi, duke përdorur bioponikë që mundëson prodhim të qëndrueshëm të ushqimit në kushte të kontrolluara.

Shoqëria Panorganiks, tregti me shumicë të frutave dhe perimeve nuk ka shoqëri të varur dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ